



REKOMANDIMI I PAKONTTESTUESHËM, DATA E PASIGURTË

Koment në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 29 maj të vitit 2019

30 maj 2019 година

REKOMANDIMI I PAKONTTESTUESHËM, DATA E PASIGURTË

Koment në lidhje me Raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut nga data 29 maj të vitit 2019



Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

Dr. Ardita Abazi Imeri
Dr. Malinka Ristevska Jordanova
Mr. Biljana Kotevska
Mr. Iva Conevska
Mr. Ismail Kamberi
Angel Mojsovski
Ardita Vejseli
Dora Bencetiç

Përmes Prespës deri në Bashkimin Evropian kredibil

Fryma e Marrëveshjes së Prespës e përshkon pakon e përgjithshme të zgjerimit. Nga njëra anë, kjo është një njohje për vendimet e vështira politike dhe për përcaktimin e qartë të vendit tonë në rrugën drejt BE-së. Nga ana tjetër, kjo Marrëveshje është një mundësi që të jetësohet politika edhe ashtu e brishtë për kushtëzimin përmes ruajtjes së momentit pozitiv që krijohet në rajon, por edhe më gjerë. Aq më tepër, ky vit është një test për BE, për Strategjinë e tij për Ballkanin Perëndimor dhe për kredibilitetin e tij, i cili në masë të madhe varet nga realizimi i politikës rigoroze por të drejtë, si dhe aplikimi i parimit të meritës të vendeve gjatë vlerësimit të arritjeve të tyre dhe, para së gjithash, për fillimin e negociatave me vendin tonë.

Duke i marrë parasysh deklaratat e Komisionerit Han, të cilat i paraprinë Raportit, përmbajtja e tij nuk është befasi. Raporti i validizon arritjet kryesore në politikën e jashtme lidhur me zgjidhjen e kontesteve bilaterale dhe prioritetet kryesore të reformës. Ky vit, përveç se është një udhërrëfyes për reformat e brendshme, Raporti synon kryesisht t'i bindë vendet anëtare se vendi ynë duhet t'i filloj menjëherë negociatat.

Pas një dekade rekomandime për fillimin e negociatave, këtë vit, rekomandimet për fillimin e negociatave, megjithatë janë më të ndryshme, “më të pastra”, “të qarta si kristali”, pa kushte plotësuese, nuk ka pengesa dhe ka frymë shumë pozitive. Këtë vit, vendi ynë apostrofohet si shembull për hapat e ndërmarrë pozitivë dhe progresin përmes kriterëve kyç për anëtarësim. Megjithatë, qasja e këtille nuk do të thotë se obligimet tona janë plotësuar, por na vë në një shteg akoma më të vështirë për ruajtjen e imazhit pozitiv përmes reformave më të qëndrueshme për çështjet kyçe të pasqyruara në qasjen “fillimisht bazat” dhe gjashtë iniciativat e Strategjisë për BP.

Progres është shënuar në vendosjen e lidhjeve dhe frenave në tri shtyllat e pushtetit, konsolidimi i demokracisë, vendosja e pavarësisë së gjyqësorit, formimi i Komisionit Anti-Korrupsion, zgjedhje të ndershme presidenciale. Megjithatë, Komisioni e përsërit sugjerimin e vitit të kaluar për “qasje të fuqishme” në Kapitullin 23 – Jurisprudenca dhe të drejtat themelore, Kapitullin 24 – Drejtësi, liri dhe siguri në vend.

Në këtë proces, edhe përkrah fokusit të kuptueshëm të deritanishëm dominant të vendimeve dhe hapave politikë, nuk duhet të neglizhohet marrja e obligimeve për anëtarësim dhe veçanërisht harmonizimi me *acquis* në të cilin nuk ka zhvendosje të konsiderueshme në krahasim me vitin e kaluar. Nevojitet të ndërmerren masa urgjente për fuqizimin e kapaciteteve për harmonizimin me *acquis*-dhe paralelisht me këtë përmbushjen e kriterëve administrative dhe politike.

Një sfidë serioze është edhe shfrytëzimi i fondeve nga IPA, veçanërisht sa u përket kapaciteteve administrative për projektet e mëdha infrastrukturore për të cilat Maqedonia e Veriut ka nevojë jashtëzakonisht të madhe.



Kritere politike: konsolidimi i demokracisë

Puna e Qeverisë, me kapacitet të plotë, në fushat prioritare të theksuara në konkluzionet e vitit të kaluar të Këshillit nuk kaloi pa u vërejtur. Në Raport theksohet kultura e kompromiseve, synimi drejt bashkëpunimit me të gjithë protagonistët kryesorë, duke e përfshirë opozitën dhe shoqërinë civile në mënyrë inkluzive dhe transparente. Nga ana tjetër, merren parasysh angazhimet për bashkimin/pajtimin e shoqërisë dhe ruajtjen e karakterit multietnik përmes përfshirjes së MKO në preambulën e Kushtetutës.

Progresi në sundimin e së drejtës – kriteret politike si dhe Kapitulli 23 – për jurisprudencë dhe të drejta themelore dhe Kapitulli 24 – drejtësi, liri dhe siguri, në shumicën e fushave është vlerësuar si i “mirë”, në disa fusha tjera “progres i caktuar”. Në krahasim me të gjitha shtetet e rajonit, progresi në sundimin e së drejtës është vlerësuar më së miri. Edhe sa i përket nivelit të përgatitjes, Maqedonia e Veriut nuk mbetet pas shteteve të cilat tanimë janë në procesin e negociatave – siç është Mali i Zi dhe Serbia.

Në këtë drejtim gjithësesi se janë hapat e ndërmarra bashkë me NATO-n në njërin nga pikat më sensitive – reforma e shërbimeve inteligjente, nga e cila në masë të madhe varet besimi i qytetarëve. Pritshmëri të mëdha janë shënuar për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për mënyrën transparente të zgjedhjes së anëtarëve të këtij Komisioni, si dhe fillimi premtues me hapjen e çështjeve që kanë të bëjnë me persona në pozita të larta politike. Pritshmëritë janë të mëdha edhe për ndërmarrjen e hetimeve për korrupsionin e profilin të lartë. Në këtë drejtim mbetet roli kyç i PSP, me ç’rast duhet të dëshmohet vullneti për luftimin e korrupsionit të profilin të lartë si prioritet nacional. Përveç kësaj, sukcesi i “Ushtrimit Pribe” rezultoi me mision të ngjashme, të replikuara në rajon, por edhe me paralajmërim për një mision të ri konsulent për Maqedoninë e Veriut.

Kontrolli i Parlamentit mbi procesin ligjvënës shfaqej si shqetësim në raportet paraprakë. Në këtë periudhë të raportimit, Maqedonia e Veriut është apostrofuuar si shembull i mirë për shkak të shfrytëzimit në minimum të procedurës së shkurtuar, vetëm për 20% të proceseve (sa për krahasim, në Serbi kjo përqindje është 44%). Së këtejmi, KE e nënvizoi edhe hapjen për pjesëmarrjen e organizatave qytetare në proceset e miratimit të ligjeve dhe përmirësimit të kulturës së dialogut midis pozitës dhe opozitës si shenja për përmirësimin e performancës së Kuvendit si forum për dialog politik, mbikëqyrje dhe legjislacion. Veç tjerash, është nënvizuar edhe nevoja e domosdoshme e partive politike që t’i fuqizojnë proceset e brendshme demokratike partiake përmes promovimit të lirisë së Parlamentit dhe lirisë së fjalës. KE, mes tjerash, thekson se qëndrueshmëria e këtyre reformave strukturore është një proces i gjatë, i cili kërkon përfshirje të vazhdueshme të të gjithë faktorëve, përfshirë këtu edhe gjyqtarët dhe prokurorët publikë. Një sfidë e mëtutjeshme mbeten angazhimet për parandalimin e partizimit të administratës, si dhe respektimi i parimeve të meritës dhe të përfaqësimit të drejtë. Siç u theksua më lartë, një rëndësi të veçantë për proceset e mëtutjeshme reformuese janë edhe reformat e sistemit të Prokurorisë Publike dhe zgjidhja e statusit të PSP, si dhe miratimi i Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë.

Një sfidë e mëtutjeshme mbeten edhe angazhimet për parandalimin e politizimit, si dhe respektimi i parimeve të meritës dhe përfaqësimit të drejtë në administratë. Gjithashtu, rekomandohet në klimën e përmirësuar për lirinë e medias, personat publikë dhe elitat politike ta zhvendosin kufirin e tolerancës ndaj kritikave në nivel më të lartë, me ç’rast do ta mbështesin lirinë e fjalës.

Kritere ekonomike: kthimi drejt rritjes ekonomike

Ashtu si edhe në Raportin e vitit të kaluar edhe në këtë Raport janë shënuar angazhimet për përmirësimin e menaxhimit me financat publike dhe transparencën. Megjithatë, potencohet se përbërja e shpenzimeve është përkeqësuar dhe theksohet nevoja për një konsolidim fiskal më ambicioz.

Kur bëhet fjalë për funksionimin e ekonomisë së tregut, Maqedonia e Veriut e ruajti nivelin e njëjtë si në vitin e kaluar ku kemi “progres të caktuar” dhe i njëjti është “në nivel të mirë të përgatitjes”.

Nëntë vjet pas propozimit të Komisionit, përfundimisht filloi faza e dytë e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Në këtë Raport vërehet potencimi i “garancisë rinore” dhe zbatimi i plotë i saj në mbarë territorin e vendit, veçanërisht në rajonet e pazhvilluara. Ekonomia gri vazhdon ta vështirësoj konkurrencën në sektorin privat. Sa i përket stabilitetit makro-ekonomik, rritja ekonomike filloi të shënoj rritje, por investimet janë “asfiksuar”. Shpenzimet publike janë përkeqësuar, me ç’rast transferet sociale e përbëjnë gjysmën e këtyre shpenzimeve e që është një reduktim i vogël në krahasim me vitin e kaluar. Për dallim nga e kaluara, në këtë Raport kemi një vlerësim të ri sa i përket “privatizimit dhe ristrukturimit” me ç’rast është theksuar se në vitin 2018 nuk ka kompani shtetërore të privatizuara.

Sa i përket kapacitetit të vendit të ballafaqohet me presionin e konkurrencës dhe me fuqitë e tregut në BE, me çka do të përmirësohej konkurrenca dhe rritja afatgjatë, vendi ka bërë “progres të caktuar” dhe ka një nivel mesatar të përgatitjes. Sa i përket arsimit, edhe më tutje mbesin mangësitë në programet mësimore të cilat nuk korrespondojnë me kërkesat e tregut të punës ndërsa mungesa e fuqisë së kualifikuar të punës në mënyrë plotësuese e komplikon bashkëpunimin midis kompanive vendore dhe të huaja. Nevojitet të përforcohet menaxhimi i efikasitetit të shpenzimeve në sektorin e arsimit, me qëllim që të përshpejtohet modernizimi i sistemit arsimor. Lidhjet rrugore ndërkufitare shënojnë rritje, megjithatë vendi duhet t’i përfundojë investimet në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore. Shkëmbimi tregtar me Bashkimin Evropian është i pandryshueshëm dhe vazhdon të shënoj rritje.



Bashkëpunimi rajonal: shembull dhe dëshmi për fuqinë e BE që të tërheq

Në këtë Raport titulli i këtij kapitulli u ndryshua nga “Çështje rajonale dhe obligime ndërkombëtare” në “Marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal”. Me këtë bëhet përpjekje që të lidhen iniciativat edhe ashtu të fragmentuara të Komisionit, siç janë raportet, Strategjia për Ballkanin Perëndimor (6-të iniciativat) dhe Procesi i Berlinit. Me zgjidhjen e kontestit me Greqinë dhe me Marrëveshjen bilaterale me Bullgarinë vendi ynë u bë vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor i cili nuk ka konteste bilaterale. Me këtë, Maqedonia e Veriut bëhet shembull për pajtim të cilin duhet ta ndjekin edhe vendet e tjera të rajonit gjatë zgjidhjes dhe mbylljes së kontesteve bilaterale. Ky progres e konfirmon edhe fuqinë e BE-së për tërheqje përmes perspektivës evropiane, kur ka vullnet politik.



Harmonizimi me acquis: spiranca maqedonase



Pasqyra është e ndryshme sa i përket marrjes së obligimeve nga anëtarësia, përkatësisht të kapitujve të tjerë, në të cilët në të kaluarën kryesonim. Në këto fusha vlerësimet korrespondojnë me konstatimet e vitit të kaluar – se Qeveria i jep përparësi zgjidhjes së kontestit me emrin dhe sundimit së të drejtës, megjithatë politikat në fushat e tjera, përkatësisht në kapitujt e tjerë, janë në plan të dytë. Kjo ndodhte kur mbahej skringu shpjegues për disa prej kapitujve, që gjithsesi duhej të kishte efekt stimulues për marrëdhënie më serioze. Qasja e këtillë e Qeverisë duhet të ndryshohet urgjentisht, nëse shteti ka ambicie që të negocioj i përgatitur.

Nëse i hedhim një vështrim të gjitha 33 kapitujve, përmirësime të vlerësimeve ka në 7 kapituj. Në krahasim me Raportin e vitit të kaluar, vlerësim “Progres i mirë” përveç për Kapitullin 23 dhe Kapitullin 24 ka edhe për kapituj të tjerë – Kapitullin 29: Unioni Doganor; Kapitullin 18: Statistika; Kapitullin 15: Energjia dhe Kapitullin 12: Siguria e ushqimit, politika veterinerë dhe fitosanitare. Vlerësim më i lartë sa i përket harmonizimit vërehet vetëm në Kapitullin 23: Jurisprudenca dhe të drejtat themelore, duke e pasur parasysh edhe atë se në vitin e kaluar shumica e reformave u zbatuan pikërisht në këtë Kapitull, megjithatë ishin të pamjaftueshme që ta meritojnë notën më të lartë “progres i konsiderueshëm”. “Progres i caktuar” vërehet në 18 kapituj, ndërsa akoma është i lartë numri i kapitujve në të cilët nuk janë implementuar rekomandimet – gjithsej gjashtë.

Edhe pse nga viti 2015 Komisioni Evropian ka metodologji të re, të cilën e shfrytëzon për vlerësimin e progresit dhe për nivelin e harmonizimit, në Raportin e ri në tre kapituj, edhe atë në Kapitullin 14: Politika e komunikacionit; Kapitullin 26: Arsimi dhe kultura dhe Kapitullin 27: Mjedisi jetësor na paraqitet terminologjia sipas metodologjisë së vjetër vlerësimet e së cilës janë shfrytëzuar për raportet deri në vitin 2014. Progresi në këto kapituj është vlerësuar si “Progres i kufizuar”.



Nota për progresin	Numri i kapitujve	Kapituj
Nuk ka progres (0)	6 kapituj	Kapitulli 1: Qarkullimi i lirë i mallrave; Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve; Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare; Kapitulli 8: Politika e konkurrencës; Kapitulli 13: Peshkimi; Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbrojtja shëndetësore.
Progres i caktuar (1)	18 kapituj	Kapitulli 3: E drejta e themelimit dhe liria e sigurimit të shërbimeve; Kapitulli 4: Liria e lëvizjes së kapitalit; Kapitulli 5: Prokurime publike; Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale; Kapitulli 9: Shërbime financiare; Kapitulli 10: Shoqëria informatike dhe mediat; Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural; Kapitulli 16: Tatimimi; Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare; Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi; Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale; Kapitulli 21: Rrjete trans-evropiane; Kapitulli 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve stukturore; Kapitulli 25: Shkenca dhe hulumtimi; Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë; Kapitulli 31: Siguria e jashtme dhe politika e mbrojtjes; Kapitulli 32: Kontrolli financiar; Kapitulli 33: Dispozita financiare dhe buxhetore.
Progres i mirë (2)	6 kapituj	Kapitulli 12: Siguria e ushqimit, politika veterinerë dhe fitosanitare; Kapitulli 15: Energjia; Kapitulli 18: Statistika; Kapitulli 23: Jurisprudenca dhe të drejtat fundamentale; Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria; Kapitulli 29: Unioni Doganor.
Progres i kufizuar (limited progress) (terminologji e vjetër e cila paraqitet përsëri në vitin 2019)	3 kapituj	Kapitulli 14: Politika e komunikacionit; Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura; Kapitulli 27: Mjedisi jetësor.



Përsëri – pasiguri për datën

Për shkak të hapit të ndërmarrë të madh të Maqedonisë së Veriut në planin e brendshëm, dhe “arritje historike” në planin e jashtëm, sipas Komisionit, negociatat aderuese me Maqedoninë e Veriut duhet të hapen tani.¹ Çdo përpjekje që të mos realizohet premtimi i BE-së e dobëson stabilitetin dhe e dekurajon ndërmarrjen e reformave serioze. Sipas KE, nëse Maqedonisë së Veriut nuk i hapet drita e gjelbër për hapjen e negociatave, atëherë BE rrezikon ta humbas kredibilitetin në rajon dhe më gjerë, përfshirë këtu edhe potencialin e saj që të ndikoj në zgjidhjen e kontesteve të hapura, siç është dialogu Beograd-Prishtinë.² Komisioni Evropian e vendos edhe në kontekst më të gjerë mospërmbushjen eventuale të BE-së që të përcaktoj datë për negociatat për vendin tonë, duke i vënë në dukje konsekuencat e mundshme gjeopolitike, përkatësisht se mungesa e përgjigjes së qartë nga BE mund të aktivizojë spirale të mbështetjeve që “konkurrentët gjeopolitikë të strehohen në pragun e Evropës”.

Rekomandimi i BE-së për Maqedoninë e Veriut është bindës. Tani pikëpyetja e madhe nuk është “çka” por “kur” mund të presim. Sipas konkluzioneve të Këshillit të BE nga qershori i vitit 2019, vendimi për datën lidhur me Konferencën Ndërqeveritare me të cilën duhet të fillojnë negociatat duhet të miratohet në qershor, ndërsa data të jetë deri në fund të këtij viti. Këshilli i BE-së duhet ta ngarkoj Komisionin që të përgatis kornizë negociuese.

Afati deri në fund të vitit për konferencë ndërqeveritare tani për tani nuk vihet në pikëpyetje, por në pikëpyetje vihet ky qershor si afat për caktimin e datës konkrete të Konferencës. Shtetet anëtare tanimë nuk kanë pretekste për mangësitë e palës maqedonase – Raporti i Komisionit e pamundëson një gjë të këtillë. Prandaj, tani ka pretekste në anën e BE-së. Edhe pse hija e madhe e mbisundimit të euroskeptikëve e cila marrë në përgjithësi do ta rrezikonte projektin evropian është evituar, ka procese të tjera të cilat janë prioritarë për vendet anëtare. Para se gjithash, këto janë negociatat politike në periudhën pas zgjedhjeve, kur shtetet anëtare fokusohen mbi çështjet e ndarjes së funksioneve sipas rezultateve të zgjedhjeve. Disa vende anëtare edhe më tutje janë të përmbajtura, duke i pasur parasysh rezultatet e zgjedhjeve për Parlamentin Evropian – siç është Franca. Gjermania thotë se nuk do të arrij ta përfundoj procedurën parlamentare. Përmendet një “Prolongim i vogël” të vendimit për datë – deri në shtator-tetor, por kjo e bart me vete prolongimin e mëtutjeshëm të datës së Konferencës Ndërqeveritare. Kjo shkon në favor të euroskeptikëve “vendas”, të cilët këtë taktizim të vendeve anëtare do ta interpretojnë si blerje kohe, si mungesë e vullnetit për pranim.

Shqetëson vetëdija e ulët e shteteve anëtare të BE-së në rast të mospërmbushjes nga ana e tyre të obligimeve të ndërmarrura ndaj Maqedonisë së Veriut për pasojat e mundshme në rajon, madje edhe më gjerë. Pasojat e mundshme për shtetin janë motivimi i ulët për reforma, nxitja e klimës për ndarje politike, madje edhe krizë e mundshme politike. Gjithsesi se përforcimi i debatit rreth asaj se a ia vlen të “saktifikohet” e bërë me Marrëveshjen e Prespës do të dominojë në diskursin publik, me ç’rast seriozisht do të rrënohet vullneti dhe angazhimet jo vetëm të Qeverisë, por edhe të të gjitha forcave të cilat e mbështetën Marrëveshjen e Prespës. Pastaj, rreziku është real nga humbja e plotë e besimit në procesin e zgjerimit dhe në parimet e tij.

Për shkak të këtyre rreziqeve, ndërsa pavarësisht të njëjtave, Qeveria duhet t’i vazhdojë impenjimet diplomatike të udhëzuara mirë dhe të vazhdojë me reformat, por në kuadër të strategjisë qartësisht të përcaktuar me prioritet qartësisht të inkuorpuara nacionale.

1 “[T]he Commission recommends that the Council now opens accession negotiations with North Macedonia.”

2 Në Strategjinë e zgjerimit, KE thekson se, “përgjigje e vakët ndaj progresit historik dhe reformave të rëndësishme do ta rrënoj stabilitetin dhe seriozisht do t’i dekurajoj reformat e mëtutjeshme, si dhe punën në çështjet sensitive bilaterale, si për shembull dialogu Beogra-Prishtinë”.

PIKËPAMJE DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

1. Raporti përmban një mesazh të qartë dhe pa ekuivoke për Këshillin për ta përcaktuar datën e negociatave në bazë të rezultateve, si dhe t'i shpreh mirënjohje shtetit për punën e kryer.
2. Këshilli i BE-së duhet t'i respektojë obligimet e marra dhe në qershor ta caktoj datën e mbajtjes së Konferencës ndërqeveritare – deri në fund të këtij viti.
3. Çlirimi gradual i vendit nga “kapja” është vërejtur në më shumë fusha, përfshirë këtu edhe sistemin e lidhjeve dhe frenave, rolin e Dhomës Ligjvënëse dhe lirinë e fjalës, si dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile. Hapat e parë pozitivë lidhur me fushat të cilat deri më tani ishin objekt shqetësimi, siç është lufta me korrupsionin, pavarësia e gjyqësorit, lufta me diskriminimin etj., duhet të vazhdojnë përmes zbatimit të ligjeve të sapo-miratuara.
4. Harmonizimi me legjislacionin e BE edhe më tutje mbetet spiranca maqedonase. Vendi akoma stagnon në shumë kapituj. Qeveria duhet t'i rris impenjimet për harmonizimin me legjislacionin e BE-së, veçanërisht në kapitujt të cilët stagnojnë në vazhdimësi, ndërsa Komisioni Evropian ta rris mbështetjen e këtyre proceseve.
5. Pavarësisht se kur dhe çfarë vendime do të marrin shtetet anëtare të BE-së për fillimin dhe rrjedhën e negociatave, Qeveria duhet të ndërtoj strategji të qarta për aderimin në BE, në të cilën do t'i inkorporoj prioritetet nacionale, me përfshirjen e të gjitha subjekteve relevante politike dhe kapaciteteve profesionale.
6. Është e domosdoshme që Komisioni Evropian të akordoj fonde të konsiderueshme për projekte infrastrukturore, duke e përfshirë këtu energjetikën, si dhe ekonominë dhe rritjen e punësimit. Qeveria si prioritet duhet ta ketë fuqizimin e kapaciteteve administrative për shfrytëzimin e fondeve të IPA – veçanërisht të atyre për infrastrukturë.



Shtojca: Pasqyra e konkluzioneve dhe vlerësimeve lidhur me përmbushjen e detyrimeve nga 2011-2019

Kapitulli	Progresi								Niveli I harmonizimit							
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2018	2019	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2018	2019
1. Qarkullimi i Lirë i Mallrave	1	2	1	1	1	1	0	0	3	4	4	4	3	3	3	3
2. Lëvizja e Lirë e Punëtorëve	1	1	1	1	1	1	0	0	1	1	1	1	1	1	1	1
3. E Drejta e Themelimit dhe Liria e Sigurimit të Shërbimeve	1	1	1	1	1	1	0	1	1	3	3	3	3	3	3	3
4. Qarkullimi i Lirë i Kapitalit	1	1	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3	3	3
5. Prokurime Publike	1	1	2	1	1	0	1	1	5	4	4	4	3	3	3	3
6. E drejta e Shoqërive Tregtare	2	2	2	2	1	1	1	0	3	3	4	4	4	4	4	4
7. E drejta e Pronës Intelektuale	1	1	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3	3	3
8. Politika e Konkurrencës	1	2	2	2	1	0	0	0	3	4	4	4	3	3	3	3
9. Shërbimet financiare	2	1	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3	3	3
10. Shoqëria Informatike dhe Mediat	1	1	1	2	1	0	0	1	3	3	3	3	4	4	3	3
11. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural	1	1	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3	3	3
12. Siguria e Ushqimit, Politika Veterinare dhe Fitosanitare	2	2	2	1	1	1	1	2	4	3	3	3	2	2	4	4
13. Peshkimi	1	1	1	1	1	2	0	0	3	3	3	4	3	3	3	3
14. Politika e Komunikacionit	1	1	1	1	1	1	1	1	4	3	3	3	3	3	3	3
15. Energjia	2	1	1	1	1	1	1	2	3	3	3	3	3	3	3	3
16. Tatimimi	1	1	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3	3	3
17. Politika ekonomike dhe monetare	3	1	1	1	1	1	1	1	4	4	4	4	3	3	3	3
18. Statistika	2	1	2	2	1	1	1	2	4	3	4	4	3	3	3	3
19. Politikat Sociale dhe Punësimi	1	1	1	1	1	1	1	1	2	2	1	3	3	3	3	3
20. Ndërmarrjet dhe politika industriale	1	1	1	1	1	1	0	1	3	3	3	3	3	3	3	3
21. Rrjete trans-europiane	1	1	1	1	2	2	1	1	4	3	4	4	4	4	4	4
22. Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	1	1	1	1	0	1	1	1	3	3	2	2	3	3	3	3
23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore	1	1	1	1	0	0	2	2	3	3	3	4	2	2	2	2,5
24. Drejtësia, Liria dhe Siguria	1	1	1	1	1	1	2	2	4	4	4	4	3	3	3	3
25. Shkenca dhe Hulumtimi	1	1	2	2	2	1	1	1	2	2	2	3	4	4	4	4
26. Arsimi dhe kultura	1	1	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	3	3	3
27. Mjedisi jetësor	1	1	1	1	1	1	1	1	3	3	3	3	3	2	2	2
28. Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbrojtje shëndetësore	1	1	1	1	1	0	0	0	3	3	3	3	3	3	3	3
29. Unioni Doganor	2	1	1	1	2	1	1	2	4	4	4	4	4	4	4	4
30. Marrëdhëniet me Jashtë	1	1	1	1	1	1	1	1	4	3	3	3	3	3	3	3
31. Politika e jashtme, e Sigurisë dhe Mbrojtjes	2	2	3	1	1	1	1	1	5	5	5	3	3	3	3	3
32. Kontrolli financiar	1	1	1	1	1	0	1	1	2	1	1	3	3	3	3	3
33. Dispozitat dinanciare dhe buxhetore	1	1	0	1	1	1	1	1	3	1	1	1	1	1	1	1

Shënim: Instituti përdor metodologjinë e vet, me ç'rast në pasqyrimin e vlerësimit të përgjithshëm, vlera e kapitujve të veçantë është ponderuar duke e pasur parasysh vëllimin dhe rëndësinë e tyre

Shpjegime për kuantifikimin e vlerësimeve sa i përket progresit dhe përputhshmërisë

Vlerësimet e përdorura për raportet gjër në vitin 2014:

Progresi:		Përputhshmëria:	
Vlerësimi	Vlera numerike	Vlerësimi	Vlera numerike
Vlerësimi	(-5)-(-1)		
Regres	0	Nuk ka filluar	0
Nuk ka progres; nuk ka progres të mëtutjeshëm	1	Faza e hershme; faza shumë e hershme; faza fillestare	1
Nuk ka progres thelbësor; nuk ka progres të veçantë; progres i pakënaqshëm; progres i ngadaltë; progres fillestar, progres i kufizuar	2	Nuk ka shënuar progres të madh; shënon progres; progres i ngadalshëm	2
Progres i vogël; progres modest, progres i caktuar	3	Progres mesatar	3
Progres; progres i mëtutjeshëm	4	Progres i avancuar, në fazë të avancuar	4
Progres i mirë; progres evident; progres i qëndrueshëm; progres i kënaqshëm	5	Progres i mirë	5

Vlerësimet për vitin 2015, 2016, 2018 dhe 2019 në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian:

Vlerësimi - progres	Vlera numerike		Vlerësimi i përputhshmërisë	Vlera numerike
Regres	(-5)-(-1)			
Nuk ka progres	0		Nuk ka filluar	0
Progres i caktuar	1		Fazë e hershme e gatishmërisë	1
Progres i mirë	2		Nivel i caktuar i gatishmërisë	2
Progres domethënës	3		Nivel i moderuar i gatishmërisë	3
			Nivel i mirë i gatishmërisë	4
			Nivel i lartë i gatishmërisë	5

Për të siguruar krahasueshmëri sipas metodologjisë së re të Komisionit evropian me vlerësime më parë të dhëna, është bërë rivalorizim i vlerave për vitin 2013.

Analizat e Institutit për politikë europiane për raportet e mëparshëm të KE i gjeni në:

- 2018: <https://bit.ly/2EGCQtL> (MKD); <https://bit.ly/2wr3i67> (ALB); <https://bit.ly/2WdlK1p> (ENG)
- 2016: <https://bit.ly/2JMXGMe> (MKD); <https://bit.ly/2MfuBeh> (ALB); <https://bit.ly/2Mfrkf9> (ENG)
- 2015: <https://goo.gl/IQB99q> (MKD); <https://goo.gl/9r7ZTs> (ALB); <https://goo.gl/OF6L7Y> (ENG)
- 2014: <https://goo.gl/pOJi0J> (MKD); <https://goo.gl/eBjt4v> (ALB); <https://goo.gl/2RkFnU> (ENG)
- 2013: <https://goo.gl/sBwze9> (MKD); <https://goo.gl/sBwze9> (ALB); <https://goo.gl/sBwze9> (ENG)
- 2012: <https://goo.gl/5LkbqQ> (MKD); <https://goo.gl/5LkbqQ> (ALB); <https://goo.gl/ROcPI3> (ENG)
- 2011: <https://goo.gl/6uWzI6> (MKD); <https://goo.gl/ikAhRx> (ALB); <https://goo.gl/f47DTe> (ENG)

